

VENDIM
Nr. 156, datë 12.3.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS-KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, faza e parë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 17 853 204 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 17 853 204 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Durrës.

8. Bashkia Durrës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Durrës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Durrës për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Durrës për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
 “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS–KËNETË DHE SISTEMIMIT NË RRJETIT TË UJËRAVE
 TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRESIT, FAZA E PARË”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			SHËNIME (KUFIZIME KADASTRALE, BARRË MBI PASURINË etj.)
												ARË			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqe (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	
1	Shahin		Dulla	Durrës	3184	70/1	arë	2600	2600	10	183	326	554	180,604.00	
2	Han	Shahin	Dulla	Durrës	3184	70/2	arë	2600	2600	10	184	357	554	197,778.00	
3	Fatmir		Dulla	Durrës	3184	70/5	arë	2600	2600	10	187	345	554	191,130.00	
4	Flamur	Shahin	Dulla	Durrës	3184	70/8	arë	1300	1300	10	190	241	554	133,514.00	
5	Bajram	Met	Dulla	Durrës	3184	70/9	arë	1560	1560	10	191	255	554	141,270.00	
6	Ahmet		Dulla	Durrës	3184	70/11	arë	1300	1300	10	193	176	554	97,504.00	
7	Feride		Oruçi	Durrës	3184	70/12	arë	1300	1300	10	194	192	554	106,368.00	
8	Lavdrim	Sadri	Oruçi	Durrës	3184	70/13	arë	650	650	10	195	167	554	92,518.00	
9	Rabije		Oruçi	Durrës	3184	70/14	arë	1950	1950	10	196	324	554	179,496.00	
	Aferdita		Avdia												
	Manushaqe		Oruçi												
	Marime		Oruçi												
	Zahide		Halili												
	Valbona		Shehu												
10	Hamdi	Kamber	Oruçi	Durrës	3184	70/19	arë	2600	2600	10	201	398	554	220,492.00	
11	Arben		Oruçi	Durrës	3184	70/20	arë	650	650	10	202	183	554	101,382.00	
12	Luan	Hysen	Istrefi	Durrës	3184	70/21	arë	8320	8320	10	203	1168	554	647,072.00	
13	Naim		Istrefi	Durrës	3184	70/22	arë	6500	6500	10	204	946	554	524,084.00	
14	Halil	Ramadan	Istrefaj	Durrës	3184	70/23	arë	8320	8320	10	205	1167	554	646,518.00	
	Kadime	Rrahman	Dida												
	Nikolla	Rrahman	Sinamati												
	Manushaqe	Rrahman	Peposhi												
	Shyqyrie	Rrahman	Lugja												
15	Halil		Istrefi	Durrës	3184	70/24	arë	6500	6500	10	206	849	554	470,346.00	
16	Zenel		Braha	Durrës	3184	70/25	arë	2600	2600	10	207	456	554	252,624.00	
17	Xhelal		Brahaj	Durrës	3184	70/26	arë	2600	2600	10	208	555	554	307,470.00	
18	Raiffeisen Bank SH.A			Durrës	3184	63/115	arë	22546	22546	9	103	4009	554	2,220,986.00	
19	Selami	Ram	Gjocaj	Durrës	3184	63/26	arë	1000	1000	2	226	183	554	101,382.00	
20	Alush		Thaçi	Durrës	3184	63/30	arë	3000	3000	7	114	455	554	252,070.00	
21	Arben		Kokomani	Durrës	3184	63/35	arë	1000	1000	2	235	177	554	98,058.00	
22	Agim	Safet	Elezi	Durrës	3184	63/36	arë	1000	1000	2	236	184	554	101,936.00	
	Shpresa	Safet	Elezi												
	Fatos	Safet	Elezi												
	Ilir	Safet	Elezi												
23	Arben		Kokomani	Durrës	3184	63/37	arë	1000	1000	2	237	151	554	83,654.00	
24	Arben		Kokomani	Durrës	3184	63/40	arë	1000	1000	2	240	137	554	75,898.00	
25	Jak	Gege	Musteqja	Durrës	3184	63/64	arë	1000	1000	2	184	196	554	108,584.00	
26	Mark	Gege	Musteqja	Durrës	3184	63/65	arë	1000	1000	2	185	166	554	91,964.00	
27	Pieter	Jak	Musteqja	Durrës	3184	63/66	arë	1000	1000	2	186	177	554	98,058.00	
28	Arben		Kokomani	Durrës	3184	63/120	arë	2004	2004	10	141	316	554	175,064.00	
29	Agim	Safet	Elezi	Durrës	3184	63/121	arë	2004	2004	12	57	389	554	215,506.00	

	Shpresa	Safet	Elezi												
	Fatos	Safet	Elezi												
	Ilir	Safet	Elezi												
30	Agim	Safet	Elezi	Durrës	3184	63/122	arë	5010	5010	12	58	916	554	507,464.00	
	Shpresa	Safet	Elezi												
	Fatos	Safet	Elezi												
	Ilir	Safet	Elezi												
31	Febius		Gerveni	Durrës	3184	63/117	arë	12500	12500	9	119	2236	554	1,238,744.00	
32	Sara		Agalliu	Durrës	3184	63/118	arë	12537	12537	9	120	2057	554	1,139,578.00	
	Halil		Gashi												
33	Energia B Sh.P.K			Durrës	3184	63/119	arë	56782	56782	9	139	9977	554	5,527,258.00	
34	Ramadan		Voka	Durrës	3184	17/59	arë	5092	5092	11	94	10	554	5,540.00	
35	Shoq. Ferra &Co			Durrës	3184	16/65	arë	40502	5092	12	201	857	554	474,778.00	
36	Sokol	Hamza	Dilaj	Durrës	3184	15/5	arë	7684	7684	1	225	588	554	325,752.00	
	Belul	Muharrem	Qama												
	Gezim	Tetem	Kapaj												
37	Fatmir	Asllan	Gega	Durrës	3184	93/4	arë	10500	10500	5	44	940	554	520,760.00	
Vlera totale														17,853,204.00	